



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 1.6.2021

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 1.6.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen që i përket ankimit kundër vendimin nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe u nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet e palëve dhe provat e administruara nga Kolegji, në cilësinë e provës gjatë hetimit gjyqësor, në përfundim, duke iu përmbajtur shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve me shkrim, të paraqitura në këtë gjykim në seancat e datave 30 mars, 1 prill, 19 prill, 11 maj dhe 27 maj 2021, konstatohet se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

Për të mos përsëritur parashtrimet me shkrim, të paraqitura nga Komisioneri Publik në seancat gjyqësore të listuara më lart, në vijim qëndrimi i përmbledhur, në përfundim të gjykimit të çështjes.

Kështu, Komisioneri Publik, në mënyrë shteruese, në seancën e datës 1.4.2021, ka parashtruar me shkrim përpara këtij trupi gjykues, argumentet ligjore bazuar në të cilat pretendimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit, është i pabazuar në ligj.

Ndërkohë, për sa i takon shkaqeve të ankimit, referuar edhe parashtrimeve me shkrim gjatë këtij gjykimi, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe profesionalizmit, edhe pas shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje nga ana juaj, hetimit gjyqësor të kryer, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, mbeti e provuar se:

A. Për shkakun ankimor për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. *Lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, “apartament banimi dhe garazh”, me adresë rruga: “*** **”, pallati “*** & ***”, ap. nr. ***, Tiranë, me sip. banimi 97,16 m,² si dhe të ardhurave që kanë shërbyer për të mbuluar shpenzimet e deklaruara për mobilimin e kësaj pasurie*

1.1 Përfundimet në ankim për këtë shkak janë se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, për sa i përket burimeve të deklaruara të përdorura për krijimin e kësaj pasurie dhe shpenzimeve të mobilimit, konkretisht: (i) të ardhura nga kredia me kushte lehtësuese, e marrë nga *** Bank, në vitin 2007; (ii) kursime nga të ardhura të subjektit dhe bashkëshortes nga puna ndër vite¹.

1.2 Në analizë të shkakut të ankimit, mbi burimin e deklaruar të ardhura nga kredia në shumën 5.000.000 lekë, disbursuar nga ***, në datën ***.3.2007, e investuar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, fillimisht, në bono thesari, në periudhën ***.4.2007 - ***.10.2008 dhe tërhequr në cash gjatë periudhës 2007 - 2008:

1.2.1 Në deklaratat periodike të periudhës 2007 - 2010, subjekti nuk ka deklaruar posedim apo destinacion të shumave të tërhequra në cash me burim kredinë e vitit 2007, në përmbushje të detyrimit të tij në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, duke bërë të pamundur kështu kontrollin e ekzistencës apo ndryshimeve të mundshme mbi këto likuiditete për një

¹ Kursime të cilat janë deklaruar nga subjekti se kanë shërbyer si burim për shlyerjen e një pjese të vlerës së apartamentit të blerë, kështu të parë, paguar në datën ***.4.2015, në shumën 12.600 euro, mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të këtij apartamenti në shumën 2.000.000 lekë, si dhe mbulimin e kursimeve të poseduara në cash, të deklaruara në Deklaratën “Vetting”, në shumën 800.000 lekë.

periudhë rreth 4-vjeçare². Ndërkohë, në deklaratimet e viteve 2007 - 2010, subjekti ka deklaruar shpesh të kursimeve në *cash* me burim: nga paga dhe shpërblimet.

1.2.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik, mbështetur edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, lidhur me "*likuiditetet në cash*"³, ka vlerësuar se lidhur me këtë burim, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 1, 3 dhe 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa "b", nenit 61, pika 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016.

1.2.3 Gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur gjatë hetimit administrativ, mbi konceptin e tij lidhur me deklaratimet periodike vjetore, duke mos paraqitur asnjë provë apo fakt të ri, për të ndryshuar qëndrimin e Komisionerit Publik dhe, rrjedhimisht, për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 37.400 euro, që rrjedh nga depozitimet në *** Bank e *** ***, në vitet 2010 - 2011, e deklaruar nga subjekti si e ardhur me burim fillestar kredinë e vitit 2007.

1.3 Në analizë të shkakut të ankimit, mbi burimin e deklaruar: *kursime cash gjatë periudhës 2003 - 2016*, me burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, Komisioneri Publik, duke ritheksuar edhe njëherë vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore në procesin e rivlerësimit, i qëndron shkakut se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, zëri: *kursime në cash*, duhej llogaritur sipas deklaratimeve të subjektit në deklaratat të interesave private dhe pasurore, të paraqitura në ILDKPKI, si për shumën e deklaruar të kursyer, ashtu dhe për burimin e deklaruar, mbështetur kjo dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit.

1.4 Për sa i përket të ardhurave të dhuruara nga vëllezërit për periudhën 2011 - 2016, në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë nënçështje të ankimit, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 1.4.2021, paraqiti akte dhe provoi mundësinë financiare të vëllait ***. ***. për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e dhuruara subjektit, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore. Gjithsesi, edhe në konsideratë të ndikimit të tyre në situatën financiare të subjektit për këto vite,

² Duke qenë se subjekti deklaroi se depozitimet fillimisht në *** Bank dhe me pas në *** ***, në vitin 2011, kanë si burim kredinë e disbursuar në vitin 2007.

³ Kolegji i Posaçëm i Apelit ka trajtuar në disa vendime lidhur me deklaratimin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet: (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të prg. 27; (JR) nr. 19/2019 në prg. 84; (JR) nr. 20/2019 në prg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në prg. 31; (JR) nr. 27, datë 22.10.2020.

aktet e sjella nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, mbështetur në shkaqet e tjera të ankimit mbi mungesën e burimeve për krijimin e pasurisë.

1.5 Në përfundim për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë: “*Apartament me sip. 97,16 m² dhe garazh*”, referuar nenit D, pikat 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe në situatën e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar tërësisht shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, të përdorura për krijimin e të ardhurave që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë mbi këtë pasuri, si dhe mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të saj.

B. Për shkakun ankimor për vlerësimin e aftësive profesionale

2. Vlerësimi i aftësive profesionale është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale, të kryer nga Grupi i Punës, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në dokumentacionin bashkëlidhur tij, si dhe (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese.

2.1 (i) *Të dhëna nga burime arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, në Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit*

2.1.1 *Lidhur me ankesat e gazetarit ***. ***, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm⁴, referuar jurisprudencës orientuese të Kolegjit⁵ për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar aftësi për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, nuk ka mbledhur provat e nevojshme të kërkuara me ligj, nuk ka treguar aftësinë për të marrë në pyetje, mosveprime të cilat kanë çuar në shmangien nga dënimi më i rëndë i autorëve të kryerjes së veprës penale në disa episode, kanë sjellë pasoja të rënda për shtetas të tjerë, të cilat, eventualisht, mund të ishin shmangur në rast të hetimit të plotë të kallëzimit, të depozituar nga shtetasi ***. ***, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut në rolin e organit të Prokurorisë.*

2.1.2 *Lidhur me ankesën e avokates ***. ***, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijenit Inspektorit të Etikës pranë Prokurorit të Përgjithshëm. Komisioneri Publik vlerëson se rasti në fjalë duhet trajtuar si shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të profesionit, parashikuar nga neni 103 i*

⁴ Protokolluar me nr. ***, datë ***.1.2014 dhe nr. ***/***, datë ***.1.2014, nga Zyra e Sektorit Publik, pranë Prokurorisë së Përgjithshme

⁵ Vendimi (JR) nr. 29/2019, në prg. 19.2; dhe Vendimi (JR) nr. 2/2020, në prg. 31.3.

ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁶, si dhe sjellje në kundërshtim me rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve⁷.

2.1.3 *Lidhur me mangësitë procedurale të konstatuara nga trajtimi i dosjeve të përzgjedhura me short, pjesë të Raportit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, hartuar nga GPPP.* (i) Dosja nr. 1, vendimi datë ***.9.2016, “Për mosfillimin e procedimit penal”, për kallëzimin nr. ***, i datës ***.4.2016; (ii) Dosja nr. 2, Procedimi penal nr. ***, i vitit 2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, hetimet e të cilit janë pushuar në datën ***.9.2013; (iii) Dosja nr. 3, Procedimi Penal nr. ***, viti 2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, hetimet e të cilit janë pushuar në datën ***.12.2013, Komisioneri Publik, në analizë të fakteve dhe rrethanave të konkluduara edhe nga GPPP-ja mbi 3 (tre) dosjet e trajtuara, si dhe në vlerësim tërësor të çështjes, çmon se gjetjet e përsëritura të këtyre rasteve duhen vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, bazuar kjo edhe në jurisprudencën e Kolegjit⁸.

2.2 (ii) Vlerësimi i denoncimeve të paraqitura

2.2.1 *Lidhur me të dhënat e dala nga denoncimi i shtetases ***. ***, nr. *** prot., datë ***.12.2019, depozituar në Komision, pas zhvillimit të seancës dëgjimore datë 10.12.2019, Komisioneri Publik çmon se, dhe pas çeljes së hetimit gjyqësor në Kolegj, aktet e paraqitura, situatën e provueshmërisë e lënë të njëjtë.*

2.3 Referuar *rezultatit të hetimit gjyqësor për dy denoncime*, në lidhje me përmbajtjen e të cilave, kryesisht, nga vetë ky trup gjykues, në seancën e datës 19.4.2021, u vendos të çelet hetimi gjyqësor dhe të kërkohen nga institucionet aktet përkatëse, akte këto të administruara nga ky trup gjykues, në seancën e datës 11.5.2021 dhe 27.5.2021, Komisioneri Publik konstatimet e tij i ka parashtruar me shkrim në seancën e datës 27.5.2021.

3. Kërkimi përfundimtar i ankimit

3.1 Në përfundim të këtyre bisedimeve përfundimtare, Komisioneri Publik, në referencë të analizës së provave/akteve të administruara në dosje të Komisionit, provave dhe akteve të administruara gjatë hetimit gjyqësor, të vendosur nga trupi gjykues, si dhe parashtrimeve dhe akteve/provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës, gjatë këtij hetimi

⁶ Po ashtu, parashikuar si shkelje disiplinore edhe në nenin 32 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligj në fuqi në vitin 2015.

⁷ http://www.pp.gov.al/web/rregullat_e_etikes_dhe_sjelljen_e_prokuroreve_820.pdf

⁸ Vendimi (JR) nr. 10/2021 i Kolegjit, në prg. 10.

gjyqësor, duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të paraqitur prej tij, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5, dhe nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon, nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA